


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Tetor 2019

**Tiranë, më 18 Nëntor 2019:** Në Tetor 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u ulur me 10,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 8,3 %, në krahasim me Shtator 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 59 mld lekë, duke u rritur me 1,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 13,3 %, në krahasim me Shtator 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 32 mld lekë, duke u rritur me 14,3 %, krahasuar me Tetor 2018 dhe me 17,9 %, në krahasim me Shtator 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në dhjetëmujorin e vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 252 mld lekë, duke u ulur me 3,6 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 540 mld lekë, duke u rritur me 2,9 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 288 mld lekë, duke u rritur me 9,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 10,3 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: "Materiale ndërtimi dhe metale" me -3,2 pikë përqindje, "Makineri, pajisje, pjesë këmbimi" me -2,8 pikë përqindje, "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -2,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: "Produkte kimike dhe plastike" me +0,2 pikë përqindje, "Lëkurë dhe artikuj prej tyre" me +0,04 pikë përqindje.

**Për publikim 18/11/2019**

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2019 (p.p)**




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë ulur me -3,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,2 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,5 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej 1,6 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,4 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,1 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -1,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,2 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,5 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2019 (p.p)**



Si dhjetëmujor, importet janë rritur me 2,9 %, krahasuar me dhjetëmujorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,5 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,5 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,3 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,2 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -0,04 pikë përqindje.

#### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Tetor 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2018 janë: Spanja (3,7 %), Gjermania (4,1 %), dhe Maqedonia (3,5 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-6,7 %), Kosova (-9,1 %) dhe Greqia (-18,5 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (12,9 %), Gjermania (5,8 %), dhe Kina (13,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-2,6 %), Spanja (-13,3 %) dhe Greqi (-4,6 %).

Në muajin Tetor 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Tetor 2018 janë: Turqia (+20,5 %), Greqia (+9,5 %), dhe Gjermania (+0,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-10,1 %), Kina (-1,5 %) dhe Spanja (-64,0 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (14,5 %), Turqia (11,2 %) dhe Greqia (8,1 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-6,0 %), Gjermania (-7,5 %) dhe Rusia (-12,4 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2019



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 63,3 %, të gjithë tregtisë. Në Tetor 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 56,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,7 %), Turqia (7,5 %), Greqia (6,6 %) dhe Kina (6,5 %).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin e parë 2019, me vendet e BE-së zënë 64,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Tetor 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,4 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,7 %), Greqia (7,2 %), Kina (6,9 %) dhe Turqia (6,4 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626		-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	09 - 17	24	17,0	53	10,9	-29	45,1
	10 - 17	25	14,5	58	15,5	-33	43,1
	Janar - Tetor 17	226	13,5	511	7,8	-285	44,2
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	10 - 18	30	21,3	58	1,2	-28	51,7
	Janar - Tetor 18	262	16,0	525	2,8	-264	49,8
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	09 - 19	25	-4,9	52	2,3	-27	47,8
	10 - 19	27	-10,3	59	1,6	-32	45,7
	Janar - Tetor 18	252	-3,6	540	2,9	-288	46,7

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Tetor 2018	Tetor 2019	Jan.- Tet. 2018	Jan.- Tet. 2019	Tetor 2018	Tetor 2019	Jan.- Tet. 2018	Jan.- Tet. 2019
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>22.918</b>	<b>21.089</b>	<b>199.723</b>	<b>192.554</b>	<b>35.778</b>	<b>32.855</b>	<b>323.549</b>	<b>315.979</b>
Austri	190	199	1.490	1.549	539	503	5.565	5.756
Mbretëri e Bashkuar	312	76	1.009	613	531	437	4.853	4.664
Gjermani	1.151	1.199	11.334	11.987	4.266	4.278	40.535	37.504
Greçi	1.339	1.091	11.150	10.641	4.134	4.526	43.185	46.668
Itali	13.428	12.527	125.162	121.882	16.115	14.481	145.897	137.137
Spanjë	2.970	3.079	20.831	18.063	2.879	1.037	13.899	9.396
Kroaci	112	135	757	922	585	543	5.363	5.747
Të tjera të BE-së	3.417	2.784	27.991	26.897	6.730	7.050	64.252	69.108
Kinë	557	528	4.697	5.341	5.077	5.002	43.105	49.339
Kosovë	2.958	2.690	22.423	25.317	934	723	7.375	6.624
Maqedonia e Veriut	757	784	7.240	7.060	882	755	7.905	7.119
Rusi	4		35	75	830	1.181	11.229	9.834
SHBA	388	220	4.313	3.190	915	2.510	7.624	10.490
Turqi	327	137	1.884	1.746	5.196	6.262	43.699	48.605
Ukrainë	24	8	202	128	501	150	2.483	2.564
Zvicër	32	147	2.815	780	675	1.786	7.499	12.881
Të tjera	2.147	1.410	18.285	15.937	7.444	7.920	70.772	77.008
<b>Gjithsej</b>	<b>30.111</b>	<b>27.012</b>	<b>261.616</b>	<b>252.128</b>	<b>58.233</b>	<b>59.144</b>	<b>525.240</b>	<b>540.444</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tetor 2018	Tetor 2019	Jan.- Tet. 2018	Jan.- Tet. 2019	Tetor 2018	Tetor 2019	Jan.- Tet. 2018	Jan.- Tet. 2019
<b>Gjithsej</b>	<b>30.111</b>	<b>27.012</b>	<b>261.616</b>	<b>252.128</b>	<b>58.233</b>	<b>59.144</b>	<b>525.240</b>	<b>540.444</b>
Ushqime, pije, duhan	3.934	3.655	26.269	29.075	8.762	9.270	89.040	91.674
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	5.516	4.814	49.581	41.410	5.948	6.790	53.220	65.168
Produkte kimike dhe plastike	584	654	5.168	6.544	7.784	8.401	72.799	73.821
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	204	218	2.350	2.053	1.802	1.599	15.794	14.602
Prodhime druri dhe letre	994	916	7.459	7.958	2.545	2.235	20.956	21.445
Tekstile dhe këpucë	10.821	10.340	103.844	100.649	8.684	7.953	72.610	72.376
Materiale ndërtimi dhe metale	4.915	3.963	45.082	38.807	7.281	6.571	64.941	67.364
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	2.414	1.566	15.010	18.083	12.977	13.625	115.194	113.570
Të tjera	729	885	6.855	7.548	2.450	2.699	20.686	20.424

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
<b>Gjithsej</b>	<b>125.162</b>	<b>121.882</b>	<b>22.423</b>	<b>25.317</b>	<b>20.831</b>	<b>18.063</b>	<b>11.334</b>	<b>11.987</b>
Ushqim. pije duhan	6.604	7.153	2.252	2.977	1.080	1.079	1.194	1.406
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	4.095	4.696	5.309	6.031	16.663	14.705	1.790	811
Produkte kimike dhe plastike	1.336	1.732	1.102	1.792	54	49	27	54
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.725	1.713	9	5	216	188	10	12
Prodhime druri dhe letre	5.223	5.301	394	739	6	4	129	152
Tekstile dhe këpucë	80.033	78.332	91	95	2.619	1.855	5.828	6.324
Materiale ndërtimi dhe metale	14.734	11.428	11.438	11.590	150	170	748	1.291
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	8.229	8.382	716	620	30	8	1.168	1.258
Të tjera	3.182	3.146	1.112	1.468	11	5	440	678

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
<b>Gjithsej</b>	<b>145.897</b>	<b>137.137</b>	<b>43.105</b>	<b>49.339</b>	<b>43.699</b>	<b>48.605</b>	<b>43.185</b>	<b>46.668</b>
Ushqim. pije duhan	14.725	16.166	571	671	4.710	4.589	12.737	13.189
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	10.447	7.196	7	7	659	3.207	6.781	10.652
Produkte kimike dhe plastike	15.498	15.333	4.116	4.731	6.700	6.764	6.384	6.419
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	12.177	11.595	637	641	269	227	49	23
Prodhime druri dhe letre	6.129	5.701	930	882	2.859	2.884	2.861	2.944
Tekstile dhe këpucë	35.253	34.109	8.700	9.628	13.800	14.714	3.124	3.045
Materiale ndërtimi dhe metale	17.556	15.725	5.717	7.814	6.435	8.943	7.373	6.897
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	29.201	26.768	18.150	20.327	6.213	5.545	2.386	2.248
Të tjera	4.912	4.542	4.277	4.638	2.055	1.730	1.491	1.250

# Metodologjia

## Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Slovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri